



Të folurit me fëmijët rreth

# ORIENTIMIT NË KARRIERË





## ORIENTIMI NË KARRIERË

Qëllimi i zgjedhjes së karrierës për të rinjtë është gjetja e një profesioni që i përshtatet më së miri interesave dhe aftësive të tyre. Të rinjtë që kanë gjetur një punë të përshtatshme janë më të kënaqur dhe më produktivë, kanë rrezik më të vogël të papunësisë, janë më të qëndrueshëm dhe më pak të prirur për të ndërruar profesionet. Këto janë parakushte të rëndësishme për rritjen personale dhe zhvillimin e një personaliteti të pavarur. Qytetarët autonomë, siç janë këta, janë shumë të rëndësishëm për demokracitë e gjalla. Vetëm ata që janë të informuar dhe të angazhuar mund të marrin vendime të pavarura dhe të përgjegjshme për të jetuar në bashkëjetesë demokratike.

Jadoni, biri juaj 15-vjeçar, po fillon vitin e tij të fundit të arsimit të detyrueshëm. Në takim informues me prindër, mësuesi thekson rëndësinë e zgjedhjes së ardhshme të karrierës së nxënësve, duke përfshirë mbështetjen e prindërve për fëmijët e tyre. Ai i inkurajon të gjithë që ta diskutojnë temën në shtëpi dhe brenda familjes, po ashtu. Ju e shihni se Jadoni nuk flet vetë për temën e zgjedhjes së karrierës. Prandaj, ju vendosni ta angazhoni atë në një bisedë rreth saj. Por, si do të ketë sukses një bisedë e tillë?

Zgjedhni nga opsionet në vijim dhe vazhdoni me leximin në faqen e treguar:



Shkoni te [faqja 3!](#)



Shkoni te [faqja 4!](#)



Shkoni te [faqja 5!](#)

### Disa rregulla të thjeshta:

- Përfshihuni, por mos mbani kontroll.
- Këshilloni, por mos vendosni.
- Mbështetni, por mos mbizotëroni.

### **Informata/materiale/video të mëtuqeshme mund të gjenden këtu:**

QualifaX : Baza e të dhënave për edukimin e mëtejshëm dhe të lartë në Irlandë (Departamenti i edukimit dhe shkathtësive, Irlandë)

[http://www.qualifax.ie/index.php?option=com\\_content&view=article&id=179&Itemid=207](http://www.qualifax.ie/index.php?option=com_content&view=article&id=179&Itemid=207)



Të gjithë prindërit duan vetëm më të mirën për fëmijët e tyre. Në lidhje me profesionin e parashikuar të pasardhësve të tyre, shumë prindër e lidhin zgjedhjen e karrierës me status të lartë, punësim të sigurt dhe të ardhura të mira. Dhe shumë besojnë se kjo mund të arrihet vetëm me një diplomë universiteti.

Megjithatë, kërcënimet dhe sjellja patronizuese me siguri nuk janë të dobishme për të bindur Jadonin për nevojën që të diplomojë në shkollë me nota të mira. Prandaj është e rëndësishme ta krijoni dhe mirëmbani një klimë të mirë për diskutime. Kjo gjithashtu i ofron birit tuaj mundësinë për të ushtruar kompetencën e tij demokratike. Në të bërit kështu, ju duhet të përmbaheni nga të ashtuquajturat mesazhe destruktive. Për këshilla dhe sugjerime përkatëse, vazhdoni leximin në [faqen 6](#).

Mundohuni të mësoni rreth interesave të Jadonit dhe aspiratave profesionale në një bisedë të hapur. Pastaj, së bashku mund të ndërmerri kërkimin për punë të përshtatshme që përputhen me këto pritshmëri.

Në [faqen 7](#) mund të gjeni këshilla dhe sugjerime të rëndësishme për prindërit që dëshirojnë të mbështetin Jadonin në kërkimin e tij për një profesion të përshtatshëm.



Ndër sfidat më të rëndësishme të zhvillimit adoleshent është procesi i pavarësimit nga familja dhe prindërit. Prandaj, zgjedhja e karrierës është një hap kritik, nëse jo më i rëndësishmi, në jetën e një të riu drejt një ekzistence të pavarur dhe të vetëvendosur.

Pasi që ju, si person i rritur dhe prind, jeni plotësisht në dijeni të rëndësishme së këtij vendimi, është shumë e kuptueshme që ju doni ta mbështetni dhe ta këshilloni birin tuaj sa më shumë që të jetë e mundur. Megjithatë, mbani në mend se, në fund të fundit, është Jadoni ai i cili do të duhet të jetojë me vendimin dhe t'i bartë pasojat e këtij vendimi. Ai do ta ndjekë aspiratën e karrierës në mënyrë më të qëndrueshme dhe rrjedhimisht do të punojë dhe do të mësojë më intensivisht drejt saj, nëse vetë ka vendosur në mënyrë aktive për zgjedhjen e karrierës.

Prandaj, është më e këshillueshme që ta duroni mosveprimin e birit tuaj, edhe pse mund të jetë e vështirë për ju, se sa ta mbushni hendekun me aktivizmin tuaj. Nëse ju ofroni shumë përkrahje për Jadonin, kjo mund të rezultojë madje edhe në kundërreagim të fortë nga ana e tij. Është shumë e mundshme që, tash e tutje, ai të mos ju kushtojë më vëmendje fare për këtë temë.

Për sugjerime dhe këshilla se si ta mbështetni në mënyrë të qetë birin tuaj, vazhdoni me leximin në [faqen 7](#).



Duket sikur keni gjetur mënyrën e duhur për ta angazhuar birin tuaj në bisedë për të ardhmen e tij. Urime!

Bëjani të qartë Jadonit se zgjedhja e profesionit është vetëm e tija, ashtu siç ai duhet t'i bartë pasojat nga kjo, krejtësisht vetë. Sidoqoftë, si prindër dhe persona të përshtatshëm referues me bagazh të përvojës jetësore dhe dijes, gjithmonë duhet të jeni në dispozicion për të, për ndihmë lidhur me çfarëdo pyetje dhe problemi.

Për sugjerime të mëtejme dhe veprime specifike, vazhdoni me leximin në [faqen 7](#).

## Mesazhet destruktive

Mesazhet dhe deklaratat të cilat mund të provokojnë ndjenja dhe reagime negative në një fëmijë quhen mesazhe destruktive. Prindërit që lëshohen në mesazhe destruktive nuk i respektojnë dhe tolerojnë ndjenjat dhe mendimet e fëmijëve të tyre. Respekti dhe toleranca janë qëndrime themelore demokratike dhe ju nuk arrini t'ua komunikoni ato fëmijëve tuaj me mesazhet tuaja destruktive. Si pasojë, fëmija juaj ndoshta do të përgjigjet me përgjigje të shkurtra, mbrojtëse, duke u ndier i keqkuptuar dhe degraduar. Këto lloj mesazhesh çojnë në konflikte dhe, nganjëherë, ndërprejnë krejtësisht procesin e komunikimit.

Mesazhet destruktive mund të pengojnë zhvillimin psikosocial të fëmijëve. Fëmijët nuk janë në gjendje ta zhvillojnë potencialin e tyre të plotë dhe personalitet të fortë, nëse dëgjojnë vetëm mesazhe negative dhe degraduese. Megjithatë, personaliteti i fortë, qëndrimet me respekt dhe toleranca ndaj të tjerëve janë kërkesat themelore për shoqëritë demokratike e dinamike.

### Ushtrim

Për t'i bërë aftësitë tuaja të komunikimit më demokratike, duhet së pari të jeni të vetëdijshëm për praktikën tuaj aktuale të komunikimit.

Në vijim do të gjeni mesazhe të ndryshme destruktive. Vëzhgoni sjelljen tuaj komunikuese çdo ditë, për një javë. Çdo herë që përdorni një nga fjalitë e referuara kur komunikoni me fëmijën tuaj, bëni një vijë mbas asaj fjalie.

### Mesazhet destruktive

#### Komandimi, urdhërimi

- Duhet që ...
- Hajde, bëhu gati ...
- Thuaj tungjatjeta ...
- Sillu mirë ...

#### Qortimi, paralajmërimi, kërcënimi

- Ti gjithmonë bën...
- Ti kurrë nuk...
- Nëse nuk... atëherë...
- Kur, më në fund, do...
- Sa herë duhet të ta them këtë...

#### Moralizimi

- Ne do të ishim aq krenarë me ty, por tash jemi të dëshpëruar, sepse ti nuk...
- Mami është me të vërtetë e pikëlluar sepse ke qenë kaq i keq.
- Ka mijëra fëmijë të uritur të cilët do të donin ta hanë këtë.
- Një herë gënjeshtar, gjithmonë gënjeshtar.

#### Dhënia e këshillave dhe krahasimi

- Po të isha ti, unë do të...
- Prindërit e fëmijëve tjerë do të...
- Motra jote gjithmonë e rregullon dhomën e saj.
- Të gjithë pajtohen me këtë. Por ti ...

## **Si mund ta mbështes me sukses fëmijën tim në zgjedhjen e karrierës?**

- **Zogu i hershëm:** Për të shmangur presionin e kohës, përpiquni të adresoni temën e zgjedhjes së karrierës në një fazë të hershme. Kështu, nëse jeni të pavendosur, ka kohë të mjaftueshme për praktikë në grupe të ndryshme profesionale.
- **Aspirata e karrierës:** Bisedoni me birin tuaj për dëshirat, idetë dhe pritjet e tij.
- **Jashtëzakonisht e rëndësishme:** çiltërsia. Dëgjoni me qetësi djalin tuaj. Megjithëse shumë nga idetë e tij juve mund t'ju duken joreale ose të paarritshme, mos u përpiqni t'ia ngulisni atij pikëpamjen tuaj për gjërat.
- **Nuk kam asnjë ide:** Nëse Jadoni nuk ka fare ide se cilin drejtim profesional ta ndjekë, është e këshillueshme të mendohet për pyetjet e mëposhtme:
  1. Çfarë është ajo që veçanërisht të pëlqen të bësh? Për çfarë je i pasionuar? Cilët janë hobit e tu?
  2. Në cilin profesion mund t'i aplikosh këto aftësi, në cilat fusha profesionale janë pikat tua të forta dhe aftësitë e tua të nevojshme? Cilat kategori profesionale merren me çështjet që të interesojnë?
- **Për dhe kundër:** Nëse aspiratat e birit tuaj për karrierë janë disi të qarta, përpiquni të krijoni një listë me të për përparësitë dhe mangësitë e mundshme të tyre. Mund të shihet relativisht shpejt nëse profesioni i parashikuar është i përshtatshëm ose ndoshta jo aq i përshtatshëm.
- **Aktivizimi:** Mbështetni Jadonin në kërkimin për informacion rreth profesioneve specifike dhe kurseve përkatëse përgatitore. Por le ta bëjë vetë punën, si bërja e kërkimeve me telefon, caktimi i takimeve me këshilltarët e karrierës, përpilimi i materialeve të aplikimit ...
- **Praktika, praktika, praktika:** Për shumë të rinj, përvojat e veçanta praktike janë shumë më të dobishme në kërkimin e karrierës së tyre sesa përshkrimet e shkruara të punës. Prandaj, inkurajojeni Jadonin që ta krijojë një ide të punëve të rëndësishme duke bërë vizita në terren, ose duke marrë informacion të dorës së parë përmes bisedave përkatëse me të njohurit dhe të afërmit rreth profesioneve të tyre.
- **Pengesat:** Mund të ndodhin pengesa nëse duhet të mendohet për një profesion tjetër, ose kur një praktikë ose një kurs përgatitor nuk është i mundur. Në raste të tilla, ju bëni funksionin e rëndësishëm të inkurajimit të birit tuaj për të vazhduar kërkimin e tij dhe jo ta lini ta fusë kokën e tij në rërë.
- **Bëje vetë:** Sado e vështirë që të jetë për ju ta pranoni: vendimi përfundimtar duhet të jetë vetëm i birit tuaj. Një vendim është më i lehtë për t'u zbatuar nëse dikush është tërësisht pas tij. Gjithashtu, duhet të jetë e qartë për birin tuaj se vetëm ai do të duhet të bartë pasojat për vendimin e tij. Kjo do të thotë se ai merr përgjegjësinë për veprimin e tij. Procesi i marrjes së vendimeve dhe të jetuarit me pasojat është një përvojë gjatë gjithë jetës. Për më tepër, detyrimi i dikujt për të marrë vendime të informuara dhe marrja e përgjegjësisë për to është po aq e rëndësishme për mënyrën tonë demokratike të jetës dhe bashkëjetesën. Kështu, vështirë që mund të themi se po praktikohet sa duhet herët.



**“Të folurit me fëmijët rreth orientimit në karrierë” është bazuar në referencat më poshtë:**

<sup>1</sup> Qualifax, the national learners` database. *The Parent's Role in Career Selection: How important is the role of the parent in the career guidance process?* Database for further and higher education in Ireland (Department of Education and Skills, Ireland) retrieved 19.03.2019. [http://www.qualifax.ie/index.php?option=com\\_content&view=article&id=179&Itemid=207](http://www.qualifax.ie/index.php?option=com_content&view=article&id=179&Itemid=207)

<sup>2</sup> Heueck-Mauss, Doris. 2016. *So rede ich richtig mit meinem Kind: Wie Worte wirken: Konflikte fair lösen: Stressfreier erziehen*. Hannover: Humboldt, 74 ff

Heueck-Mauss, Doris. 2016. *So rede ich richtig mit meinem Kind: Wie Worte wirken: Konflikte fair lösen: Stressfreier erziehen*. Hannover: Humboldt.

Kurz, Susanne. 2014. «Unterstützen- nicht besser wissen!» *Das Schweizer Elternmagazin Fritz und Fränzi*, Mai, 76-77.

Qualifax, the national learners` database. *The Parent's Role in Career Selection: How important is the role of the parent in the career guidance process?* Database for further and higher education in Ireland (Department of Education and Skills, Ireland) retrieved 19.03.2019.

[http://www.qualifax.ie/index.php?option=com\\_content&view=article&id=179&Itemid=207](http://www.qualifax.ie/index.php?option=com_content&view=article&id=179&Itemid=207)